



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primiemo / Protetto Received / Delivered	27-06-2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SMBSHK	4940	2023	013



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.789/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Avdyl Bekteshi- Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me A.nr.789/2023 e datë 29.05.2023 e parashtruar nga ankuesi

me adresë Kodra e Dëshmorëve, Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit/ Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.789/2023 e datës 29.05.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas vendimit për ri caktim me nr.927 të datës 09.10.2018, përkatësisht aktemrimit nr.02/016-110536 të datës 10.10.2018 në pozitë të "Zyrtarit për Arsimin e Mesëm të Ulët" në kuadër të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjilanit me datë 29.05.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4501/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në lidhje me kategorizimin e pozitës së punës së tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 06.06.2023, përmes shkresës ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit me datën 15.06.2023, përmes shkresës ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, referuar ankesës A.nr.789/2023 të datës 29.05.2023 ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, si dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 29.05.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se detyrat dhe përshkrimi i punës është në harmoni me pozitën e "Zyrtarit të Lart për Arsim", kod: AR/360, grada 8 sipas Rregullores Nr.4/2020(KGJ) të muajit Korrik 2020 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Gjilanit për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale, bazuar në katalogun e vendeve të punës të aprovuar nga Qeveria e Kosovës përmes vendimit Nr.05/12 të datës 05.02.2015 plotësuar dhe ndryshuar me vendimin me Nr.09 të datës 21.02.2018 që ka qenë në fuqi sipas ligjit të vjetër të Shërbimit Civil të Kosovës Nr.03/L-149, ndërsa i njëjti përmes përmbajtjes së ankesës konfirmon se Rregullorja së cilës i referohet Nr.4/2020(KGJ) e Komunës së Gjilanit për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale nuk është zbatuar dhe si pasojë ka mbetë në pozitën sipas aktemrimit "Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët", duke potencuar edhe faktin se në të gjitha komunat e Kosovës Zyrtarët e DKA-së përkatësisht pozita që e ushtron ankuesi është e ranguar në GJ27-5.66/594.30/1, ndërsa i ankuesi thekson se më 13.03.2023 ka dorëzuar ankesë, me nr.prot.26096-23 në komunën e Gjilanit dhe se me qenë se nuk ka marrë përgjigje, në afatin vijues prej 8 ditësh ka dorëzuar edhe një njoftim nr.39634-23 datë 24.04.2023, ndërsa edhe pas këtij njoftimi nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje zyrtare dhe si rrjedhojë ka adresuar ankesë në këshill me pretendimin që të shqyrtohet meritorisht ankesa dhe që të zbatohet ligjshmëria duke kërkuar që të sistemohet në pozitë të paraparë sipas Rregullores Nr.4/2020(KGJ) të muajit Korrik 2020 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Gjilanit për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi edhe dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Gjilanit, bazuar në përgjigjen zyrtare të datës 15.06.2023 me rastin e përgjigjes në ankesë ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, andaj kolegji konstaton se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.



Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, përkatësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme edhe në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në at që u tha më lartë, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.789/2023, datë 27/06/2023.

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së